# Statuti i Shoqërisë Tregtare “Oracle Solicitors Albania” SHPK

**Neni 1**
**Ortakët**

1.1. **"ORACLE SOLICITORS ALBANIA" SHPK** është themeluar nga z. Kristi Vako, shtetas shqiptar, lindur më 10.04.1993, mbajtës i pasaportës shqiptare me nr. BD3881712, zotërues i 100 % të kapitalit themeltar dhe ortak i vetëm i Shoqërisë.

**Neni 2**
**Emri i Shoqërisë**

2.1. Emri i Shoqërisë është **"ORACLE SOLICITORS ALBANIA" SHPK** (në vijim referuar si "**Shoqëria**")

**Neni 3**
**Selia e Shoqërisë**

3.1. Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, Kati 3, 1000, Tiranë, Shqipëri".

3.2. Ortaku i vetëm mund të transferojë selinë në një adresë tjetër në çdo kohë, në përputhje me nevojat dhe interesat e Shoqërisë.

3.3. Shoqëria mund të krijojë degë ose zyrë përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë vendit, në përputhje me ligjin ne fuqi dhe procedurat e regjistrimit pas miratimit paraprak të ortakut të vetëm.

**Neni 4**
**Forma ligjore**

4.1. Shoqëria është themeluar dhe regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë ne formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar ("SHPK").

**Neni 5**
**Kohezgjatja e Shoqërisë**

5.1. Shoqëria është themeluar për një periudhë të pacaktuar.

**Neni 6**
**Aktiviteti i Shoqërisë**

6.1. Objekti i veprimtarisë të Shoqërisë do të jetë ofrimi i shërbimeve konsulence në fushat ekonomike, juridike, të administrimit të biznesit, taksave dhe burimeve njerëzore, si dhe ofrimi i shërbimeve mbështetëse administrative dhe çdo aktivitet tjetër i lejuar me ligj.

6.2. Shoqëria mund të ushtrojë çdo biznes tjetër të ligjshëm që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me veprimtarinë e saj kryesore, pa i përcaktuar saktësisht ato, si dhe të zgjerojë ose ndryshojë fushat e sipërpërmendura të veprimtarisë.

**Neni 7**
**Kapitali themeltar i Shoqërisë**

7.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej 100 lekë (*njëqind lekë shqiptare*).
7.2. Kapitali themeltar i Shoqërisë zotërohet 100 % nga z. Kristi Vako si Ortaku i vetëm i Shoqërisë.
7.3. Kuota e kapitalit të regjistruar mund të transferohet, tërësisht apo pjesërisht, tek palë të treta vetëm përmes një akti të shkruar.

**Neni 8**
**Zmadhimi i Kapitalit**

8.1. Ortaku i vetëm mund të zmadhojë kontributin e tij në kapitalin e regjistruar.
8.2. Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet gjithashtu me nënshkrimin dhe shlyerjen e kuotave të reja nga ortakë të rinj.

**Neni 9**
**Zvogëlimi i kapitalit**

9.1. Në bazë të vendimit të Ortakut të vetëm, zvogëlimi i kapitalit të regjistruar do të kryhet në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni tregtar.

**Neni 10**
**Përgjegjësia e kufizuar**

10.1. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet dhe borxhet e saj, duke përfshirë të gjitha asetet e saj.
10.2. Përgjegjësia e ortakut të shoqërisë është e kufizuar deri në vlerën e palikujduar të kontributit të tij në shoqëri.

**Neni 11**

**Organet vendimmarrëse të Shoqërisë**

11.1. Organet vendimmarrëse të Shoqërisë janë:
- Ortaku i vetëm
- Bordi i Administratoreve

11.2. Organi më i lartë qeverisës i Shoqërisë është Ortaku i vetëm. Ortaku i vetëm mund të emërojë dhe shkarkojë anëtarët e Bordit të Administratorëve.

## Neni 12
## Asambleja e Ortakut të vetëm

12.1. Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakut të vetëm.

12.2. Asambleja e Ortakut të vetëm ka të drejtë të vendosë për sa vijon:

a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
b. amendimi dhe ndryshimi i Statutit të Shoqërisë;
c. pranimi i ortakëve të rinj; bashkimi, ndarja, shpërbërja dhe çdo transformim tjetër i Shoqërisë;
d. miratimin e pasqyrave financiare vjetore të Shoqërisë dhe përdorimin e fitimeve që rezultojnë në përputhje me ligjet përkatëse;
e. miratimin e rregullores së brendshme së administrimit të Shoqërisë;
f. vendimi për shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë;
g. emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Bordit të Administratorëve të Shoqërisë dhe përcaktimi i shpërblimit të këtij roli;
h. emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar të Shoqërisë dhe përcaktimi i shpërblimit të këtij roli;
i. miratimin e buxhetit vjetor;
j. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
k. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

12.3. Në çdo rast Asambleja e Ortakut të vetëm mund të vendosë për të gjitha çështjet e tjera të parashikuara në këtë Statut ose me ligj.

## Neni 13
## Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut të vetëm

13.1. Asambleja e Ortakut të vetëm, e cila në rastin konkret përbëhet nga Ortaku i vetëm Z. Kristi Vako, mblidhet të paktën një herë brenda vitit të biznesit (mbledhje vjetore e përgjithshme).

13.2. Mbledhja e Asamblesë së Ortakut të vetëm thirret me njoftim me shkrim me kërkesë të Bordit të Administratorëve, i cili do t'u dërgohet anëtarëve të Asamblesë së Ortakut të vetëm me shërbim postar ose me postë elektronike të paktën 7 ditë përpara datës së mbledhjes.

13.3. Në mbledhjen e përgjithshme vjetore marrin pjesë të gjithë anëtarët e Bordit të Administratorëve dhe Ortaku i vetëm, mirëpo anëtarët e Bordit të Administratorëve nuk kanë të drejtë vote.

13.4. Mbledhja e Asamblesë së Ortakut të vetëm mund të mbahet edhe me video-konferencë, si dhe në një vend të ndryshëm nga selia e Shoqërisë apo edhe territorit të jashtë Republikës së Shqipërisë.

## Neni 14
## Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme te Ortakut të vetëm

14.1. Kuorumi i nevojshëm për marrjen e vendimeve të vlefshme në Asamblenë e Ortakëve është pjesëmarrja e Ortakut të vetëm.

14.2. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut të vetëm duhet të regjistrohen në një regjistër vendimesh, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo fshihen.

## Neni 15
## Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë të Ortakut të vetëm

15.1. Për çdo mbledhje të Asamblesë së Ortakut të vetëm duhet të mbahet procesverbal për mbledhjen dhe vendimet e marra. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë dhe një kopje për Ortakun e vetëm.

15.2. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga Kryetari i Asamblesë së Ortakut të vetëm dhe nga personi përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit.

15.3. Kryetar i Asamblesë së Ortakëve është Ortaku i vetëm, z. Kristi Vako.

15.4. Kopjet e procesverbalit dhe vendimeve të marra do t'i dërgohen Ortakut të vetëm me shërbim postar ose me postë elektronike.

15.5. Përgjegjësia për dorëzimin e procesverbalit i takon Kryetarit të Asamblesë së Ortakut të vetëm.

15.6. Kryetari i Asamblesë së Ortakut të vetëm është përgjegjës për dorëzimin e një kopje të procesverbalit tek Bordi Administrues i Shoqërisë, për regjistrat e tij.

15.7. Vendimet e Asamblesë së Ortakut të vetëm mund të miratohen edhe nëpërmjet miratimit në formë të shkruar të Ortakut të vetëm, pa aplikueshmërinë e rregullimeve specifike të neneve 14 dhe 15, përveç nenit 15.6 më sipër.

## Neni 16
## Administrimi i Shoqërisë

16.1. Punët e përditshme të Shoqërisë do të menaxhohen nga 1 (një) ose më tepër Administratorë. Në rast se Shoqëria ka më tepër se 1 administrator, administratorët do të krijojnë Bordin e Administratorëve. Në rast se Shoqëria operon me 1 administrator, kompetencat e Bordit të Administratorëve do të kryhen nga Administratori i vetëm.

16.2. Anëtarët e Bordit të Administratorëve mund të emërohen deri në një mandat pesë (5) vjeçar, të rinovueshëm, siç parashikohet në ligjin përkatës të Republikës së Shqipërisë.

16.3. Dy anëtarët e parë të Bordit të Administratorëve të Shoqërisë do të emërohen në këtë Statut.

## Neni 17
## Bordi i Administatoreve

17.1. Bordi i Administratorëve përbëhet nga të paktën 2 anëtarë të cilët mund të jenë ose jo anëtarë të Asamblesë së Ortakëve.

17.2. Bordi i Administratorëve është përgjegjës për manaxhimin e Shoqërisë dhe përfaqësimin ligjor të saj përballë palëve të treta.

17.3. Kompetencat dhe detyrimet e Bordit të Administratorëve bazohen në ligj, këtë statut, vendimet e Asamblesë së Ortakut të vetëm dhe rregulloret e Shoqërisë.

17.4. Bordi i Administratorëve ka kompetenca të plota për administrimin e zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe të drejtën për miratimin e të gjitha vendimeve që mund t'i duken të përshtatshme për të realizuar dhe ushtruar objektin e Shoqërisë, me përjashtim të veprimeve që sipas ligjit, këtij Statuti apo vendimeve të Ortakut të Vetëm, të miratuara herë pas here, i takojnë Ortakut të Vetëm. Në veçanti, kompetencat dhe përgjegjësitë e Bordit të Administratorëve janë si më poshtë:

a. të përfaqësojnë Shoqërinë përballë të tretëve dhe autoriteteve të tjera shtetërore;
b. të hapë, mbyllë dhe mirëmbajë llogaritë bankare të Shoqërisë;
c. të lidhë marrëveshje me palë të treta, për të lëshuar dhe marrë urdhërpagesa;
d. të nënshkruajë të gjitha dokumentet, të lëshojë fatura, të kryejë transferta në monedhë vendase dhe të huaj në emër të Shoqërisë, të paguajë detyrimet e Kompanisë dhe të pranojë letra me vlerë nga palë të treta;
e. të mbledhë detyrimet ndaj Shoqërisë;
f. të nënshkruajë kontrata pune me punonjësit e Shoqërisë;
g. të ngre padi, të përfaqësojë dhe të mbrojë Shoqërinë në rast të padive kundër saj;
h. të kryejë shpenzimet e nevojshme që lidhen me veprimtarinë e zakonshme të Shoqërisë;
i. të sigurojë që librat kontabël të mbahen në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë;
j. të sigurojë përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare të Shoqërisë;
k. të thërrasë mbledhje të zakonshme ose të jashtëzakonshme të Asamblesë së Ortakëve; përcakton rendin e ditës për takime të tilla; merr masat e duhura për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjeve të Asamblesë së Ortakut të vetëm; ndërmerr veprimet e nevojshme për të njoftuar ortakët për vendimet e veçanta dhe siguron bërjen e të gjitha veprimeve dhe njoftimeve të tilla në kohën e duhur;
l. të marrë vendim për çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë e brendshme të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj me të palë të treat;
m. të marrë çdo vendim tjetër për veprimtarinë e zakonshme të Shoqërisë në përputhje me ligjin, këtë Statut dhe në interes të shoqërisë.

17.5. Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe me vendim të Ortakut të vetëm, anëtarët e Bordit të Administratorëve do të kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e sipërcituara, duke përfshirë edhe përfaqësimin e Shoqërisë përballë të tretëve, bashkërisht dhe/ose veçmas, sikundër ata e konsiderojnë të volitshme. Për të hequr çdo dyshim, secili nga anëtarët e administratorëve mund të çelë individualisht llogaritë bankare të Shoqërisë në Shqipëri.

## Neni 18
## Eksperti/ët Kontabël i/të Miratuar

18.1. Eksperti/ët Kontabël i /të miratuar do të caktohen me vendim të Ortakut të Vetëm nëse është e nevojshme.

## Neni 19
## Emërimi i Bordit të Administratorëve

19.1. Anëtarët e Bordit të Administratorëve të Shoqërisë janë:
- Z. Sajjad Ahmed Shan, shtetas i Mbretërisë së Bashkuar, lindur më 23.02.1971, mbajtës i pasaportës angleze me nr. 517036525, për një afat 1 vjeçar;
- Z. Kristi Vako, shtetas i Republikës së Shqipërisë, lindur më 10.04.1993, mbajtës i pasaportës nr. BD3881712, për një afat 1 vjeçar;

19.2. Bordit i Administratorëve mund të nënshkruajë dokumente në emër të Shoqërisë dhe të përfaqësojë Shoqërinë përpara autoriteteve shqiptare, në përputhje me nenin 17/5 të Statutit.

19.3. Shoqëria është e lidhur nga marrëveshjet e nënshkruara në mënyrë të rregullt në emër të Shoqërisë nga Bordit i Administratorëve.
19.4. Anëtarët e Bordit të Administratorëve së Shoqërisë mund të shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve.

## Neni 20
## Viti financiar, pasqyrat financiare

20.1. Viti fiskal i Shoqërisë është një periudhë 12-mujore nga 1 janari deri më 31 dhjetor të çdo viti. Viti i parë fiskal zgjat nga data e regjistrimit të Shoqërisë deri më 31 dhjetor të atij viti.
20.2. Në fund të çdo viti fiskal Bordit i Administratorëve do të kryejë detyrat e mëposhtme:

a. përgatitja e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;

b. përgatitjen e bilancit, i cili paraqet gjendjen financiare të Shoqërisë;

c. përgatitja e një deklarate së fitimit dhe humbjes.

20.3. Pasqyrat financiare do të paraqiten për miratim në mbledhjen e vjetore të asamblesë së bashku me raportin e auditorëve të jashtëm, nëse ka, deri më 30 qershor të vitit të ardhshëm fiskal.

## Neni 21
## Fitimet e Shoqërisë

21.1. Asambleja e Ortakut të vetëm do të marrë vendimin për shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë.

## Neni 22
## Shpërbërja dhe likuidimi

22.1. Shoqëria do të mbyllet dhe likuidohet në rastet e mëposhtme:

a. me vendim të Ortakut të vetëm;

b. nga bashkimi me një shoqëri tjetër;

c. me vendim gjykate të juridiksionit përkatës, në çdo rast të parashikuar me ligj;

d. në çdo rast tjetër të parashikuar me ligj.

22.2. Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të saj do të bëhet në përputhje me ligjet dhe dispozitat ligjore përkatëse.

## Neni 23
## Mosmarrëveshjet juridike dhe gjykata kompetente

23.1. Në rast të mosmarrëveshjeve që lindin në lidhje me këtë statut ose për shkak të ligjit, këto mosmarrëveshje do të zgjidhen nga gjykata kompetente që ka juridiksion.
23.2. Ligji i aplikueshëm do të jetë ligji i Republikës së Shqipërisë.

23.3. Në rast mospërputhje midis versionit anglisht dhe shqip të këtij Statuti, versioni anglisht do të mbizotërojë.

Nënshkruar më 13.07.2022 në tre kopje origjinale në anglisht dhe shqip.

Gjuha angleze do të jetë gjuha zyrtare për qëllimin e interpretimit të këtij Statuti.

Nënshkrimi i Ortakut të vetëm:

Z. Kristi Vako